

REALIZMI SOCIALIST IDEOLOGJIA DHE PROPAGANDA



Arti pamor

Fjalë kyçe: Ideologji, propagandë, art, letërsi, formalizëm.

Ardian Isufi

Universiteti i Arteve - Tiranë. Fakulteti i Arteve të Bukura.

Abstract

Një ndër veprat e Leninit, që u mor si model, ku bëri të mundur zhvillimin e artit dhe letërsisë në vendin tonë, ishte një artikull i tij, me temë: “Organizata e partisë dhe letërsia e partisë”, e shkruar në nëntor të vitit 1905. Në këtë studim të tij, Lenini theksoi parimin e partishmërisë së letërsisë dhe të arteve, si dhe luftoi kundër fenomeneve borgjeze dekadente në art dhe ishte kundër parullës borgjeze “art për art”. Një njëjta situatë u zhvillua edhe në Shqipëri, kryesisht në art dhe në letërsi. Veçori e realizimit socialist për artin dhe letërsinë, ishte mos qëndrimi jashtë sferës së ideologjisë dhe propagandës. Propaganda kishte për qëllim dy detyra, së fillim ishte forcimi i sistemit socialist dhe së dyti lufta kundër ideve borgjeze. Lenini ishte i mendimit se letërsia dhe arti nuk është një çështje private e artistëve të veçuar, por një pjesë e rëndësishme e punës së partisë, prandaj partia nuk duhet të qëndrojë duarkryq dhe të lejojë kaosin, por duhet plotësisht të udhëheq këtë proces. Lenini kërkonte që shkrimtarët dhe artistët, të mos e shkëpusin punë e tyre nga realiteti i jetës. Arti formalist pa ide sipas Leninit nuk pranohej në artin sovjetik. Duhet të luftohej ky lloj arti si një rrymë e huaj dhe armike, pasi ai prodhonte ide të çmendura, duke bërë të mundur çoroditjen e masave.

Duke dënuar formalizmin në art, Lenini shprehej se “*Unë nuk jam në gjendje t’i konsideroj veprat e ekspresionizmit, të futurizmit, kubizmit dhe “izmave” të tjera si një manifestim të lartë të gjenit artistik. Unë nuk i kuptoj këto. Lenini ka theksuar, se arti nuk duhet të krijohet për hir të një grushti të vogël njerëzish dhe as nga persona të zgjedhur, të cilët e quajnë veten mbinjerëz. Arti, i cili mundohet të jetë i pakuptueshëm për popullin, që nuk shpreh idetë dhe interesat përparimtare të tij, ky art është i huaj për popullin. Arti ynë duhet të jetë popullor, thoshte Lenini; ai duhet t’u shërbejë masave, t’u shërbejë jo dhjetë mijëve të shtresës së lartë, po miliona dhe dhjetra miliona punonjësve. Arti i takon popullit. Ai duhet që rrënjët e veta më të thella t’i lëshojë në thellësinë e masave punonjëse*”.¹

Kurse propaganda e ideve të marksizëm-leninizmit sipas Ramiz Alisë duhet ngritur “*ngritur në një nivel më të lartë dhe të lidhet më mirë me kushtet, nevojat, detyrat dhe realitetin e vendit tonë*”.²

“*Partia e punës e Shqipërisë për asnjë çast nuk do ta pushojë luftën kundër revizionizmit*”- nga fjala në mbledhjen e 81 partive komuniste e punëtoresh në Moskë.

¹ Fatmir Gjata, *Idetë e Leninit triumfojnë në artin e realizmit socialist*, botuar në revistën: “Nëntori”, nr. 4, prill, Tiranë, 1960, f. 9.

² Fjala e shokut Ramiz Alija mbajtur në kongresin e IV të PPSH, botuar në revistën: “Nëntori”, nr. 3, mars, Tiranë, 1961, f. 58.

Prania ideologjike mbi letërsinë dhe artet ishte përcaktuese në gjithë procesin e tyre letrar, krijues dhe artistik.

*“Kur bashkohen ndërmjet tyre punëtorët komunistë, qëllimi i tyre para së gjithash është të mësuarit, propaganda”.*³

Më 6 qershor të vitit 1953, Byroja Politike e Partisë së Bashkuar Socialiste të Gjermanisë Lindore, u mbledh në një takim të jashtëzakonshëm, për të diskutuar rreth vizitës së delegacionit në Moskë. Në përfundim të këtij takimi u vendos:

- 1- Të hartohet një raport, ku të kishte frymë autokritike, i cili do i paraqitej KQ të PKBS;
- 2- U vendos krijimi i një komisioni për të kryer reformën e organizimit të Byrosë dhe Sekretariatit;
- 3- U vendos rishikimi i menjëhershëm i një posteri propagandistik etj.

*“Propaganda jonë duhet t’u adaptohet shoqërisë dhe njerëzve. Ka elemente të propagandës dhe të edukimit, që janë të fiksuara, të njëllota për të gjithë, por ka edhe nuanca, ka edhe zhvillim të këtij edukimi dhe të kësaj propagande, e cila duhet të evitohet shabllonizmin, të evitohet rutinën dhe burokratizmin”.*⁴

Komunizmi në Shqipëri, i frymëzuar nga veprat e Karl Marksit, Leninit apo Trocky-t mbi historinë njerëzore si fenomen i shfrytëzimit të punëtorisë prej pronarëve për hir të ekonomisë, kishte si synim të saj, ndërtimin e një regjimi autoritar, ku gjithçka ishte nën diktatin e partisë, pra thënë ndryshe këtij lloj sistemi i shkonte për shtat shprehja: “Iu përket të gjithëve dhe askush nuk zotëron asgjë”.

Sipas *“teorisë marksiste-leniniste”*⁵, detyrat në lëmin e punës ideopolitike ishin:

- Të ngrihet niveli teorik i partisë në lartësinë e duhur;
- Të përforcohet puna ideologjike në të gjitha hallkat e partisë;
- Të zhvillohet një propagandë të palodhur të leninizmit në radhët e partisë;
- Të edukohen organizatat e partisë, në frymën internacionalizmit leninist;
- Të demaskohet sistematikisht ideologjia dhe mbeturinat e ideologjisë së rrymave armiqësore për leninizmin.

E njëjta situatë paraqitet edhe në Shqipëri, si në artet, por edhe në letërsi, si në rastin:

³ Marks Engels, *Mbi kulturën dhe artin*, Shtëpia Botuese “Rilindja”, Prishtinë, 1974, f. 70.

⁴ Enver Hoxha, *Gjithmonë vigjencë* - për organet e punëve të brendshme, vëllimi II, f. 510.

⁵ V.L. Lenin & J. V. Stalin, *Mbi rolin udhëheqës të partisë në ndërtimin socialist*, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1981, f. 308.

“... Amerika me Angli
qenë propagandaxhi,
në luftë me Gjermani...”⁶

Enver Hoxha kërkonte që ta fuste në “grackë” rininë dhe gjithë popullin, përmes edukimit ndaj masave. Kështu që Partia do t’i kushtonte rinisë vëmendjen më të madhe, duke bërë edukimin ideologjik të saj. Edukimi bëhej përmes propagandës së mirë ideologjike dhe nëse dikush dilte kundër kësaj vije, atëherë fundi i tij dihej.

Siç e thotë edhe piktori Edison Gjergo se në Shqipëri, po fole një fjalë të merr lumi. Propagandën më të theksuar e kishte kujtesa kolektive, ku të gjithë ishin të detyruar të shikonin programet, aktivitetet dhe apo filmat, që në përmbajtje të tyre kishin formim të pastër ideologjik.

“Programet e televizioneve tona janë të këqija dhe të mërzitshme. Arti ynë vuan nga rutina, nga skematizmi dhe standardet. Se njeriu këtu nuk është i lirë të bëjë ç’të dojë dhe të shkojë ku të dojë. Këtu po fole një fjalë të mori lumi”⁷.

Edukimin e masave-shprehet piktori Ali Oseku e kam vuajtur në lëkurën time. Çdo gjë duhet të bëhej çfarë të thonin ata dhe si të donin ata. Ai sjell në rrëfimin e tij, një sekuencë të kohës, kur ishte në qytetin e Elbasanit për riedukim.

“Ideologjia dhe propaganda e kanë shtypur artistin gjatë kohës së regjimit komunist dhe sidomos pas viteve ’73. Gjatë kohës kur më çuan për riedukim në Elbasan, më kishin vënë të punoja punëtor krahu, ngarkim-shkarkim dhe nuk iu përgjigjesha punës që ata kërkonin. Pra si të thuash ndaj tyre unë rebelohesha shumë. Aty në Elbasan dëgjova një ngjarje, ku grua ishte mbytur në një pus, në përpjekje për të shpërtuar një fëmijë dhe më pas bëra një dekor për këtë ngjarje që dëgjova. Uaaa - thanë ky qenka edhe piktor. Më pas bëra një portret të thjeshtë të Enver Hoxhës. Ky portret ishte rreth katër metra, por ishte diçka e thjeshtë, si të thuash me të fërkume, kjo ishte edhe metoda sovjetike. Në atë kohë unë rebelohesha shumë. Nuk iu bindja të bëja punën që më kishin caktuar, punëtor krahu, ngarkim-shkarkim dhe për të dal nga situata iu thoja, kam kryer punën time, kam vizatuar Enver Hoxhën katër metra e kenë”⁸.

Të rinjtë dhe të rejtat ishin të detyruar të lexonin të gjitha dokumentet e partisë dhe veprat e Enver Hoxhës, e gjithë kjo propagandë bëhej, që të brumosnin tek të rinjtë “idealet” e Partisë së Enver Hoxhës.

⁶ Selim Hasani, *Rapsodi popullore*, Tiranë, 1966, f. 48.

Shih: Silvana Leka, *Kaligrafia e teksteve me imazhet e vrazhda të diktaturës në tekstet poetike të Robert Priftit*, botuar në revistën: “Poeteka”, nr. 34, e cila është pjesë dhe partner e rrjetit të revistave kulturore evropiane EUROZINE, Ministria e Kulturës, Tiranë, 2015, f. 84-88.

⁷ Dosja e hetuesisë/Ministria e Brendshme, nr. 10667/1-A, “Për të pandehurin Edison Gjergo”, Akuza: “Agjitacion dhe Propagandë”, Në bazë të nenit 73/I, Data e fillimit 13 janar 1975, Data e mbarimit 8 prill 1975.

⁸ Intervistë me piktorin Ali Oseku (16.02.2019).

Sistemi i kohës frikën më të madhe e kishte prej artisëve dhe shkrimtarëve, sigurisht që mbi ta rëndonte edhe survejimi më i madh. Në akt-akuzën e piktorit Edison Gjergo, del se piktorin e akuzojnë për agjitacion dhe propagandë, duke u shprehur ndaj tij kështu: “I pandehuri Edison Gjergo, ka zhvilluar agjitacion dhe propagandë, ku nga hetimet doli se: *“Nga viti 1970 ka qenë në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve. Ky i pandehur pa qenë i molepsur me ideologjinë borgjezo-revizioniste dhe i prirë pas artit modernist, dekadent. Ka bërë piktura me përmbajtje reaksionare, dekadente dhe moderniste, për të cilat është kritikuar herë pas here nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve”*.⁹

Jetësimin e realizmit socialist në Shqipëri e provokonte dhe e promovonte më së miri, vetë lideri i saj, Enver Hoxha, ku jeta dhe shëndeti i individit shkonte lidhur në koherencë të plotë me jetën dhe luftën e Partisë.

*“Jeta dhe shëndeti ynë janë të lidhur ngushtë me jetën dhe me luftën e Partisë”*¹⁰, duke u mbështetur në *“karakterin ideologjik”*.¹¹

Propaganda në realizmin socialist përgjatë viteve '70 kishte të bënte së pari me përforcimin e kultit të partisë. Çdo kush që nuk punonte apo nuk respektonte kultin e partisë, konsiderohej “Armik i Popullit”, më pas internohej, burgosej apo pushkatohej së bashku me familjen. Propaganda e promovimit të kultit të partisë ishte e mishëruar nëpër: aktivitete masive, kongrese, dëgjesa publike, revista, gazeta, sheshe, teatro, pra në vendet të cilat populloheshin nga shumë njerëz.

Shpërlaja e trurit të të rinjve sipas porosisë së Enver Hoxhës, duhet të bëhej nga organizatat e rinisë së partisë, duke përdorur të ashtuquajturën metodën e ballafaqimit. Metodë kjo e iniciuar nga vetë Partia-shtet, për të bërë të mundur mësimet e kësaj të fundit.

*“Organizatrat e Rinisë”*¹² kishin për detyrën të ngrinin nivelin e punës edukative, duke e bërë atë sa më konkrete, të dukshme dhe të argumentuar mirë, të ishte e lidhur ngushtë me problemet e jetës së përditshme, të punës, të sjelljes, me qëndrimet e secilit, duke luftuar me çdo kusht shfaqjet e formalizmit.

Rinia ishte e detyruar të përvetësonte mësimet e marksizëm-leninizmit, mësimet e Partisë e të udhëheqësit të saj Enver Hoxhës, për të bërë të mundur forcimin e vijës politike dhe ideologjike dhe për të dhënë shembullin e tyre të masat. Duke “ngrënë këtë lloj ushqimi” rinia i përvetësonte mësimet e Partisë së Enver Hoxhës, përmes shtypit, librit, radios e televizionit, muzikës e pikturës, kinemasë, teatrit, shtëpive e vatrave të kulturës, rretheve të krijimtarisë letrare, artistike dhe

⁹ Dosja e hetuesisë/Ministria e Brendshme, nr. 10667/1-A, “Për të pandehurin Edison Gjergo”, Akuza: “Agjitacion dhe Propagandë”, Në bazë të nenit 73/I, Data e fillimit 13 janar 1975, Data e mbarimit 8 prill 1975.

¹⁰ Enver Hoxha, *Letra të zgjedhura*, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1985, f. 389.

¹¹ Floresha Dado, *Letërsi e painterpretuar*, Bota Shqiptare, Tiranë, 2010, f. 147. “Termi ‘karakter ideologjik’, është shprehje e një situatë të re ideore në jetën e shoqërisë, kur teoria marksiste e lidhi qëndrimin e autorit me luftën e proletariatit. Ishte hapi i parë për të bërë një komandim, një orientim të thelbit të brendshëm të letërsisë”, si rrjedhim edhe i artit në përgjithësi dhe arteve pamore në veçanti.

¹² Kongresi i 7-të i BRPSH - Elbasan, 26-29 shtator, Botim i KQ të BRPSH, Tiranë, 1977, f. 26.

teknike e shkencore. Pra Enver Hoxha e kishte qëllim në vetvete edukimin politik dhe ideologjik të rinisë shqiptare.

Në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të, sidomos prej viteve 1960 e këndeje, korrespondenca e qytetarëve me zyrat shtetërore mori një përmasë të jashtëzakonshme. Vetëm udhëheqjes politike qendrore i dërgoheshin mesatarisht “*gjashtë mijë letra në vit*”.¹³

Pjesa më e madhe e këtyre letrave kanë pasur si qëllim si të ndihmojnë partinë komuniste për të përsosur ideologjikisht shtetin, “*për të mbrojtur pastërtinë e sistemit*”¹⁴ dhe për të forcuar parimet e marksizëm-leninizmit.

Nga 15 dhjetori 1973 deri më 20 janar 1974 në të gjitha organizatat bazë të partisë si dhe në kolektivat punonjëse të institucioneve artistike kryesore, u zhvilluan konkluzionet e byrosë së K. P. të rrethit dhe materialet e tjera.

Në Lidhjen e shkrimtarëve dhe artistëve, pas debatit të madh kundër shfaqjeve të huaja borgjeze-revizioniste në letërsi e art si dhe qëndrimeve liberale ndaj tyre, debat ky që u ndriçua dhe u udhëhoq në bazë të raportit të pleniumit IV të K. Q. të Partisë, fjalimeve të Enver Hoxhës.

Propaganda përmes kultit të partisë, e gjejmë në parakalimet me rastin e 1 Majit. Sloganet të cilat zinin hapësirën e faqeve të para të revistave të kohës, si: revista “Ylli” e vitit 1971, revista “Fatosi” e datës 1 Janar 1976, revista “Pionieri”, shkurt 1976.

Kultin e partisë e gjejmë në këngët me taban tradicional, si në titujt:

“Moj *Parti* t’u shtoftë nami”, “*Partia* po na mbëleth”, “Moj ideja komuniste”, “Për të dashurën *Parti*”, “Lum e lum për këtë *Parti*”, “Moj *Parti* t’u zënt’ e mbara”, “Kongresit të parë të *Partisë*”, “E tunde *Parti* e tunde”, “Shpëtimtare që *Partia*”, “Rrofsh *Parti* ku na mbështete”, “Të dalt nami moj *Parti*”, “Kur tingëllon zani i *Partisë*”, “Buçet kënga e *Partisë*”, “Rrofsh ti moj *Partia* mëmë”, “Të rrojë *Partia* thanë”.¹⁵

Ose,

“Moj *Partia* jon’ e madhe”, “Lum e lum për ty *Parti*”, “Flisni nëna flisni për *Partinë*”, “Në krye qëndron *Partia*”, “Jemi shumë krenar për *Partinë* tonë”, “Për *Partinë* shqipe mali”, “Tuj këndue lavdi *Partisë*”, “Të dalt nami moj *Parti*”, “Rrofsh *Parti* sa malet tona”, “Dhurat’ *Partija* na ka çue”, “Urim i dërgon *Partisë*”, “Kështu *Partia* ty t’ka msue”, “Të kujton gjithmonë *Partia*”, “Moj *Parti* moj famëmadhe”, “Moj *Partia* Leniniste”, “Për *Partin’ Partin’* e Punës”, “*Parti* njizetepesë vjeçare”, “O *Parti* o yll o dritë”.¹⁶

¹³ Shih raportet vjetore për letrat nga populli në vitet 1980 që ruhen në AQSH, F. 14/AP..

¹⁴ Shaban Sinani, *Letrarësia dhe vërtetësia*, botuar në revistën shkencore-kulturore: “Perla”, nr. 4, Tiranë, 2009, f. 82.

¹⁵ Për *Partinë* shqipe mali, Instituti i Folklorit, Shtypshkronja “Mihal Duri”, Tiranë, 1961.

¹⁶ Këngë për *Partinë*, Instituti i Folklorit, Shtypshkronja “Mihal Duri”, Tiranë, 1966.

*“Partia, theksonte Enver Hoxha, - ka bërë një vepër të madhe që ngriti në një pedestal të lartë dhe përjetësoi gjithë këtë pasuri të rrallë që kemi trashëguar nga e kaluara”.*¹⁷

Zhvillimi i folklorit përmes propagandës së kultit të Partisë ishte një dëshmi e qartë dhe konkrete për forcimin e vijës së Partisë dhe të mësimëve të udhëheqësit të saj, Enver Hoxhës. Puna e organizuar për zbulimin, ruajtja, zhvillimin dhe pasurimi i kulturës tradicionale folklorike, shërbente për të vënë në dukje dhe për të rrënjësuar në memorien historike kombëtare, kultin e Partisë. Organizimi i festivaleve folklorike lokale e kombëtare, siç ishin ai i vitit 1968 dhe i tetorit 1973, janë shembujt konkrete të kësaj propagande. Festivali i tetorit i vitit 1973, i cili i mbajt pas Plenumit të 4-të të KQ të PPSH (qershor 1973), provoi në mënyrë të përsosur për të dëshmuar këtë propagandë.

*“Një etapë të re, më të lartë, shënoi festivali folklorik kombëtar i vitit 1978, që pasuroi më tej të gjithë krijimtarinë popullore”*¹⁸, ku raporti i Enver Hoxhës në Plenumin e 4-të, theksonte që të thellohej lufta ideologjike kundër shfaqjeve të huaja dhe qëndrimeve liberale ndaj tyre.

Partia, duke zbatuar parimet marksiste-leniniste të ndërtimit të socializmit me forcat e veta, u udhëhoqi popullin në ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit, në fillim, e më vonë në atë të ndërtimit të plotë. Shqipëria u shndërrua në një kanier pune.

Hoxha duke ditur forcën që kishte propaganda dhe sidomos ajo lloj media, e cila shihej, dëgjohej apo përjetohej, si fjala vjen, piktura, muzika, vënia në skenë e një drame apo edhe letërsia, fokusi i forcimit të partisë dhe sigurimi i pushtetit të përjetshëm të tij ishte: “Propagandë-Propagandë-Propagandë”, e cila duhet të ishte një mision i mirë përmëshur nga të gjithë.

Faruk Borova në një studim të tij e ka sqaruar më së miri rolin e medias, duke e quajtur atë si pushteti i katërt në demokraci, e ku ndër të tjera në artikullin e tij thekson, mbi rolin që ka shpërndarja e informacioneve, përmes shtypit, radios dhe televizionit:

*“... me kalimin e viteve filloi shpërndarja e informacioneve nëpërmjet shtypit, radios dhe në vijim edhe televizionit, të cilët janë emërtuar me termin “media”. Ky institucion luan një rol të rëndësishëm në jetën e përditshme”.*¹⁹

Më pas ai në këtë studim ndalet edhe në çështjet e medias dhe të informimit gjatë kohës së realizimit socialist në vitet '70, duke na kujtuar këtë fakt:

“Edhe në sistemin socialist, në Shqipëri kishte media, por ajo media nuk e paraqiste realisht jo vetëm gjendjen ekonomike, por çdo aspekt të jetës, saqë një i huaj kur lexonte gazetën

¹⁷ Enver Hoxha, *Mbi letërsinë dhe artin*, Tiranë, 1977, f. 493.

¹⁸ Agron Fico, *Partia në këngën e popullit*, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1979, f. 8.

¹⁹ Faruk Borova, *Roli i medias si pushtet i katërt në demokraci*, botuar në revistën: “Univers”, nr. 19, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, 2018, f. 300.

Shih: Enver Hoxha, *Çështje të revolucionit dhe të ndërtimit socialist*, në: “Përmbledhje veprash”, vëll. III, f. 520. “Partia Komuniste e Shqipërisë, e frymëzuar nga ideologjia marksiste-leniniste, u bë udhëheqësjë e revolucionit. Asaj i takoi barra historike e rëndë, e vështirë, por e lavdishme: të ngrinte popullin në revolucion, ta udhëhiqte në luftë për çlirimin e atdheut dhe ta çonte në fitore atë dhe klasën punëtore, pararoja e së cilës ishte ajo vetë”.

*kryesore e cila paradoksalisht quhej “Zëri i popullit”, kuptonte se që të jetoje në Shqipëri, ishte një fat i madh. Ky emërtim i gazetës kishte domethënien e vet, se çfarë thuhej aty ishte pikërisht zëri i popullit, pra zëri i së vërtetës, pasi propagandohej se ajo media i shërbente atij populli. Pra, kjo jetë e mirë sipas medias reflektohej në nivelin ekonomik, social e kulturor, duke mos u indoktrinuar nga modernizmat e vendeve perëndimore, në të cilat sipas shtypit tonë, njerëzit ishin të zbrazët në aspektin shpirtëror, duke përdorur drogë, pije alkoolike apo ishin me imoralitet të shfrenuar. Kështu paraqitej jeta e rinisë në vendet perëndimore në mediat e kohës së socializmit”.*²⁰

Propaganda e imperializmit sipas realizmit socialist nuk bënte asgjë tjetër, veçse bënte të mundur degjenerimin e njerëzve dhe në tërësi të të gjithë shoqërisë. Si objekt i propagandës së imperializmit sipas realizmit socialist ishte ringjallja me të gjitha format dhe në të gjitha aspektet e veseve, e ndjenjave, e lakmisë, e egoizmit, etj. E tëra kjo ishte sipas realizmit socialist ishte pasqyra e fytyrës së egër të kapitalizmit, pasqyra e degjenerimit të tij. Kapitalizmi, imperializmi sipas këndvështrimit të realizmit socialist kishte frikë qoftë nga revolucioni dhe nga proletariati.

*“Vjershat banale të disa poetëve që Dritëro Agolli i godiste me të drejtë me kamxhik në një artikull të “Zërit të Popullit”, preferohen prej muzikantëve tanë dhe mbi to bëjnë muzikën”.*²¹

Po çfarë fenomeni ndodhi realisht në vitet ’70?

Vitet ’70 ose më saktë të themi nga vitet 1968-1974, pati një shpërthim, në art dhe në letërsi. Mjafton të kujtojmë nivelin modern të muzikës dhe të pikturës. Modernitetin e dëshmuar në poezinë dhe prozën shqipe, e cila në këtë fillësë shpërfaq kumte të larmishme dhe rrafshje të ngritura të shprehjes. Fenomen për vitet ’70 janë botimi i romaneve më cilësore të Ismail Kadaresë, Dritëro Agollit, Të Jakov Xoxës, Anton Pashkut etj.

Po arti dhe letërsi në funksion të kujt ishin dhe kujt duhet t’i shërbenin që ato të botoheshin dhe në fund të fundit, që jeta artistike në vend të kishte përparim, e pra *“zhvillimi i saj duhej t’u nënshtruhej qëllimeve të propagandës komuniste”*²², pasi *“letërsia dhe arti, janë mjeti më efikas i komunikimit me këto shtresa dhe regjimi komunist i kontrollon dhe i përdor në kuadrin e makinës së tij propagandistike”.*²³

²⁰ Faruk Borova, *Roli i medias si pushtet i katërt në demokraci*, botuar në revistën: “Univers”, nr. 19, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, 2018, f. 302-303.

Shih: Enciklopedia shqiptare, Akademia e Shkencave e RPSSH, Redaksia e Përgjithshme e Enciklopedisë Shqiptare, Tiranë, 1989, f. 23-24. “Artet figurative: artet në RPSSH, gjinitë dhe llojet kryesore të arteve figurative, problemet e artit të realizmit socialist, drejtimet dhe etapat kryesore të arteve figurative gjatë historisë, veprat kryesore me vlerë historike, monumentet, kishat, xhamitë, manastriret, kështjellat, objektet historike të arkitekturës. Muzika, teatri, kinematografia: gjinitë dhe llojet kryesore, veprimtaritë, shoqatat e shkollat, orkestat, teatrot, kinematë, kinostudioja, hystroia, problemet e realizmit socialist”.

²¹ Enver Hoxha, *Raporte e fjalime*, 1965-1966, f. 150.

²² Gëzim Aliu, *Romanet e Ismail Kadaresë 1963-1990 (retorika e tekstit dhe narracioni)*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2016, f. 20.

²³ Mark Marku, *Letërsia e angazhuar dhe autorë të angazhuar*, në: “Studime albanologjike”, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Tiranë, 2009, f. 71.

Në gjithë këtë sistem kontrollues dhe survejues, a mos ndoshta shqiptarët kanë jetuar në një gabim??

Pasi të duket sikur shqiptarët jetonin në një sistem, që ishte anti gjithë botës.

Shqiptarët jetonin në një vend që bëhej propagandë, bëhej propagandë për partinë, për vijën e partisë-shtet, bëhej propagandë për forcimin e “*kultit të individit*”.²⁴

Propaganda e kultit të individit, përmes sloganeve dhe shprehjeve frazeologjike të emrit të Enver Hoxhës, ishte i tej mbushur letërsia dhe arti.

Titujt e këngëve popullore, si: “*Enver o ylli me dritë*”, “*Enver Hoxh’ nuk ban ma nana*”, “*Enver Hoxha na ka pri*”, “*Enver Hoxhës*”, “*Prinë Enveri me Parti*”, “*Manua me Enverin tënë*”.²⁵

Propaganda në Shqipëri ishte e fortë dhe artistëve u kërkoi të ishin pjesë e kësaj propagande politike. Artisti shihej një vegël politike dhe kukulla lëvizëse sipas orekseve të Byrosë politike.

Regjisori Gjergj Xhuvani në lidhje me propagandën gjatë regjimit socialist do shprehej kështu:

Propaganda ishte kjo: “*Shteti ynë i vogël flamurtar marksist-leninist, është kundër ideve borgjeze*” ose parulla tjetër edhe më therëse: “*Pa bukë mund të rrinim, por idetë duhet t’i kishim të mira*”.²⁶

Lufta për socializmin krijon artistë të tipit të ri, “*që ngrenë lart flamurin e partisë*”²⁷, që e vënë krijimtarinë e tyre me ndërgjegje të plotë në shërbim të çështjes së çlirimit të proletariatit dhe të të gjithë punonjësve.

“*Ideologjia e marksizëm-leninizmit është baza monolite e zhvillimit të kulturës, letërsisë dhe artit sovjetik. Përvetësimi i thesareve të teorisë marksiste-leniniste e pasuruan krijimtarinë artistike, ngre nivelin e saj ideologjik dhe artistik, ndihmon për krijimin e veprave të denja për epokën e madhe të ndërtimit të komunizmit*”.²⁸

Realizmi socialist nxiti skematizmin, përshtatjen politike, solidaritetin me ideologjinë sunduese dhe propagandën e kohës. Letërsia dhe artet e realizmit socialist ndoqën vijë e politike të partisë dhe parimet e saj ideologjike.

²⁴ Ermir Hoxha, *Kulti i individit dhe arti totalitar*, në revistën: “Studime për artin”, nr. 14, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Departamenti i Arteve, Tiranë, 2011, f. 295. “Figura e diktatorit, e manipuluar dhe e dhënë në vlerat e udhëheqësit, prijësit, heroit, largpamësit etj., mbetet gati në çdo sistem totalitar si figura parësore, rreth së cilës ndërtohet e gjithë makina e propagandës”.

²⁵ Këngë për Partinë, Instituti i Folklorit, Tiranë, Shtypshkronja “Mihal Duri”, 1966.

²⁶ Intervistë me Gjergj Xhuvanin-regjisor (22.03.2016).

²⁷ Marksii dhe Engelsi për kulturën dhe artin, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1960, f. 23.

²⁸ Marksii dhe Engelsi për kulturën dhe artin, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1960, f. 25.

“Arti realist është i zoti ta paraqitë epokën e tij me aq forcë dhe frymë bindëse sa që figura artistike të bëhet dëshmi e kohës së tij”.²⁹

Dëmin më të madh realizimi socialist ua shkaktoi letërsisë dhe arteve ë shumë me pamundësimin e zbatimit të metodave dhe drejtimeve të tjera, se sa me kufizimet e saj të brendshme.

“Arti i vërtetë forcon tiparet e veta novatore dhe fiton një nivel të lartë artistik, kur mishëron një përmbajtje revolucionare dhe kur udhëhiqet nga idealet komuniste. Prandaj forcimi i vazhdueshëm i partishmërisë proletare mbetet gjithnjë një detyrë bazë për zhvillimin e kulturës e të arteve tona, për përparimin e tyre në rrugën e socializmit”.³⁰

Në vendet ku ishte i shtrirë realizmi socialist çështjet ideologjike ishin parësore. Çështjet ideologjike kishin të bënin ngushtësisht me lidhjen e letërsisë dhe artit, me jetën e popullit. Politika e Partisë së realizimit socialist e përpunuar mbi bazat marksiste të shëndosha, vinte në dukje rolin shoqëror triumfues të krijimtarisë artistike si dhe rolin e saj tepër aktiv në edukimin ideologjik, duke bërë të mundur ngritjen kulturore të masave.

Sipas idesë së tyre mjetet e artit të vërtetë duhet të përdoren për propagandimin e ideologjisë. Në rastin e Shqipërisë, theksi vihej te fraza: “Letërsia dhe artet, duhet të jenë gjithmonë nën vëzhgimin e partishmërisë dhe proletariatit”.

Realizmi socialist mbështetet në identifikimin e “së resë”³¹ me proletariatin dhe të proletariatit me Partinë. Ai paraqet qytetarë shembullorë, komunistë (të shkruar në Parti ose jo) - dhe armiq të klasës.

Në Shqipëri mësimet e Partisë të drejtuara nga Enver Hoxha, ku fliste për një art novator, i cili duhet të mbështetet në traditën e shëndoshë të vjetër e të re dhe në partishmërinë proletare. Shkrimtarët dhe artistët u kërkohesh për të dhënë vepra thellësisht të partishme, me qëllim pasurimin e fondit të letërsisë dhe të artit së realizmit socialist.

Konteksti politik dhe ideologjik impononte gjendjen e kontrollit ndaj mendimit, idesë, formës dhe përmbajtjes, ndaj tekstit letrar, ndaj artit të shkrimit, ndaj çdo gjejë. Kjo doktrinë imponimi kishte një estetikë normative, e cila urdhëronte shkrimin dhe letërsisë dhe krijimtarisë artistike sipas “dogmave leniniste”.³²

²⁹ Marksii dhe Engelsii për kulturën dhe artin, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1960, f. 14.

³⁰ Enver Hoxha, *Për rininë*, f. 440.

³¹ Česlav Millosh, *Mendje e robëruar*, Botimet Dritero, Tiranë, 1998.

Shih: Ismajl Bajra, *Mësimi i Leninit mbi diktaturën e proletariatit*, botuar në revistën: “Përparimi”, nr. 4, Prishtinë, 1966, f. 307-317.

³² Lidhur me mendimet e V I. Leninit për letërsinë dhe partinë, shih më tej artikullin: Organizata e partisë dhe letërsia e partisë në librin Lenini për kulturën dhe artin, Shtëpia Botuese “Nëntori”. Tiranë, 1975, f. 7-12.

Skematizmi dhe propaganda nuk kishin për objekt të tyre formën artistike, mjaftonte ilustrimi ideor, ku sipas direktivave të PPSH, aty duhet t'i përmbaheshin parimeve të soc-realizmit. Ata artistë të cilët guxuan t'i thyenin këto rregulla, sistemi nuk ua kurseu as jetën e tyre.

Po pse artistët dhe shkrimtarët thyen rregullat? Nga kush u frymëzuan?

Patjetër se ndikimin dhe mbi të gjitha frymëzimin këta artistë dhe shkrimtarë përveç “idhujve” të tyre të lexonin apo dëgjonin në fshehtësi të plotë, ndikua tek nënvetëdija e tyre edhe lëvizja studentore e vitit 1968. Ndikoi padyshim edhe ritmi modern në muzikë, pikturë dhe letërsi, të cilat trokitën në portat e diktaturës, pa marrë leje. Mesa duket diktature ishte e paaftë për të ndal këtë rrymë dhe frymë të re moderne evropiane botërore edhe në Shqipërinë e izoluar prej tyre. Pas kësaj u ndërmorën të gjitha masat që të kontrollonin dhe ndalonin përhapjen e tyre, në mënyrë që të kishte prova për të dënuar artin dhe letërsinë, artistët dhe shkrimtarët.

*“...shprehja “të shkruarit” këtu ka kuptimin e veprimtarisë kreative të një shkrimtari që duhej, po sikur të tjerët, t'u përshtatej rrethanave të shtrëngimit politik, ideologjik, shoqëror, kulturor të asaj kohe. Prandaj tekstet letrare që shkruheshin në atë kohë dhe jo vetëm, pasi edhe kinematografia, edhe arti figurativ, edhe skulptura, madje edhe muzika, duhej të bartnin mesazhin e imponuar nga pushteti. Kështu që esencë e teksteve letrare ishte retorika ideologjike. Artet krijoheshin e kultivoheshin për të shprehur artistikisht ideologjinë e kohës dhe funksioni i tyre kryesor ishte të arrinte te masat”.*³³

Në artet pamore fjala bie, shembull në këtë rast është vepra “Epika e yjeve të mëngjesit”, por tashmë e letrarizuar, ku autori i këtij romani shpjegon se: “është një roman mbi imoralitetin e diktaturës dhe të diktatorëve të saj”, ku ideologjia dhe propaganda komuniste binte mbi kokat e artistëve si alarm luftime.

Kush nuk zbatonte ideologjinë dhe propagandën komuniste, faturën e përndjekjes e kishte të siguar. Në mos zbatim të ideologjisë dhe propagandës komuniste pati edhe pasojat e saj. Në fillim u përndoqën ata shkrimtarë dhe artistë të cilët Partia i cilësoi si reaksionarë dhe që lakmonin kulturën borgjeze. Ndër të parët shkrimtarë dhe kontribuues të shkencës albanologjike shqiptare, por që pasluftës ishin përfshirë në formacione politike të tjera, u quajtën armiq dhe ndaj tyre vepruan gjyqet speciale. Emrat, si: Ernest Koliqi, Mehmet Kraja, Karl Gurakuqi, Namik Resuli, të cilët arritën të largohen nga Shqipëria, u dënuan në mungesë, duke u shpallur kriminelë dhe u ndalua kthimi i tyre në atdhe. Një emër tjetër i albanologjisë shqiptare është edhe firmëtari i Pavarësisë së Shqipërisë, Lef Nosi, i cili u pushkatua në gjyqet speciale të vitit 1945.

Ideologjia dhe propaganda komuniste veproi njëllor me emrat e të gjithë artistëve, shkrimtarëve dhe intelektualëve, ku një fenomen për kohën do shënohet edhe emri dhe imazhi i Gjergj Fishtës. Varri i “Homerit shqiptar”, “Poetit Kombëtar” dhe “Vetëdijes së Kombit” do dhunohet, madje emri i tij ishte i ndaluar të përmendej. Ai u shpall reaksionar.

³³ Gëzim Aliu, *Romanet e Ismail Kadaresë 1963-1990 (retorika e tekstit dhe narracioni)*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2016, f. 46.

“Quhem Mark Paci, jam 80 vjeç dhe jetoi në Durrës. Jam nga Domgjoni i Mirditës, unë i përkas gjakut të Homerit Shqiptar At Gjergj Fishtës, i cili në vitet 1945-1990, u imazhi dhe vepra e tij si edhe e gjithë familja dhe farefisi i tij u ndalua nga regjimi. Asnjë prej familjes së tij nuk guxonte as të ia përmendeshim emrin Gjergj Fishtës se ekzekutoheshe. Në vitet '70 unë së bashku me kushëririn tim Nik Toma, në kohën e regjimit komunist mbajtën lidhje me gjakun e At Gjergj Fishtës, duke lexuar dhe ruajtur veprat e tij. Në ato vite, ishin të ndaluara festat fetare dhe denoheshe po t'i festoje, dëshmon Mark Paci, por Nik Toma erdhi e më ftoi, për të festuar “Festën e Zojës” në familjen e tij në Fishtë, në shtator të vitit 1978.

Po flas lirshëm si vlla me vlla, i thotë Nik Toma, Mark Pacit, e dimë që janë të ndalume festat fetare, por gjaku jot në Fishtë i feston dhe je i ftum, me ardh në Fishtë, për festën e Zojës. Nika i tregon Markut, se e lutnit festen fetare, pa ra në sy, se ishte afër datës së përvjetorit të vizitës së Enver Hoxhës në Fishtë dhe po t'i lajmëronin organet e sigurimit, do iu thonin, se po festonin përvjetorin e ardhjes së Enverit në Fishtë”³⁴.

Vinçenc Prenushi, një tjetër figurë e rëndësishme e kulturës shqiptare, arqipeshkv i Durrësit, poet i njohur, i cili u dënua me njëzet vjet burg dhe vdes prej torturave në vitin 1949. Dramaturgu Ndre Zadeja (1891-1945) poeti dhe përkthyesi Dom Lazër Shantoja (1892-1945), poeti atë Bernardin Palaj (1884-1947), patër Anton Harapi (1888-1846), publicisti Gjon Shllaku (1907-1946), u arrestuan, torturuan dhe ekzekutuan. Edhe imzot Mikel Koliqi, një muzikant, do të pësojë ndëshkim, po ashtu edhe Shtjefen Kurti, do të shkojë në litar në vitet '70, për shkak se guxoi të pagëzojë në fshehtësi një fëmijë në kampet e punës në Lushnje.

Në Shqipërinë e Realizmit Socialist presioni ideologjik dhe propagandistik ishte në nivel të lartë institucional, duke përfshirë edhe jetën shpirtërore të artistëve, shkrimtarët dhe intelektualët, duke ndërtuar dikotominë në dhe *“armiku ideologjik borgjezo-revizionist”³⁵.*

“Tjetri” i parë si armik është kësaj edhe një ndërprerje dhe mbyllje të komunikimit artistik, kulturor dhe filozofik. Kultura “tjetër”, ajo kulturë e huaj, e cila nuk ishte e lejuar në Shqipërinë e realizmit socialist, është theksuar nga vetë Enver Hoxha në fjalën e mbajtur në Plenumin e 4-të, ku ndër të tjera do theksonte:

“Kjo kulturë e veshur me një shkëlqim të jashtëm-sipas Enver Hoxhës shprehur në Plenumin e 4-t të KQ të PPSH,- e shoqëruar me një reklamë të bujshme, e trajtuar në mënyrë më komerciale dhe që përkrahet e financohet nga borgjezia, vërshon në ekranin e kinemasë e të televizionit, në revista, në gazeta e në radio, në të gjitha mjetet e informacionit e të propagandës

³⁴ Intervistë me Mark Pacin-historian-etnograf, gjak i origjinës së At Gjergj Fishtës. I lindur më 13 qershor 1939 në Domgjon të Mirditës. Historian, artist, krijues, mbledhës folklori dhe materialesh arkeologjike, themelues i dhe drejtues i pesë muzeve, si në Domgjon në vitin 1973, në Rrëshen, Kukës, Bicaj, Kolosjan. Kurse Nik Toma, i lindur më 14 shkurt të vitit 1934 në Fishtë, artist, krijues, mbledhës folklori, rapsodi i parë në Zadrimë, themelues e drejtues i pesë qendrave kulturore në vitin 1972, si në: Ungrej (Kashnjet), e më vonë në Blinishtë, Fishtë, Piraj, Troshan, (Zadrimë).

³⁵ Adem Jakllari, *Sundimi i tejskajshëm i shoqërisë, “Patologjia” e akulturacionit si paradigmë zotëruese dhe format e refuzimit të saj në Shqipërinë totalitare*, në: “Pasojat e diktaturës-qëndrimi ndaj shtypjes dhe mësimet”, Botues: Konrad-Adenauer-Stiftung e.V. Zyra e Tiranës Dr. Eëillibold Frehner, f. 28.

masive. Qëllimi i saj është ta kthejë njeriun e thjeshtë në një konsumator pasiv të ideve të helmatisura borgjeze, t'ia bëjë këtë konsum një nevojë e zakon”³⁶

Frika më e madhe në vitet '70 ishte edhe hapja që mund të ndodhte, përmes artit dhe letërsisë, kështu që përmes mbajtjes së fjalimeve dhe diskutimeve, duke vënë në dukje se propaganda e imperializmit nuk ka njohur kurrë në këtë drejtim një shtrirje dhe një larmi kaq të gjerë sa në ditët e sotme për degjenerimin e njerëzve dhe të shoqërisë në tërësi, për të ringjallur në çdo formë dhe në çdo aspekt veset, ndjenjat, lakmitë, egoizmin, banditizmin e dikurshëm të atyre njerëzve dhe të atyre shoqërive që mbështesnin fuqinë e tij.

Si përfundim

Realizmi socialist kaluar përmes ideologjisë dhe propagandës, mund të themi se kjo periudhë është quajtur edhe një pasqyrë e fytyrës së egër të kapitalit, pra një pasqyrë e degjenerimit të tij.

Borgjezia ishte e dënuar kudo ajo ngrite kokën, si në letërsi, në pikturë, muzikë etj, ishte filozofia mbrojtse e këtij sistemi. Sipas ideologjisë së Realizmit socialist, Partia ndiqte çdo vepër që dilte në dritë, e cila duhet të kalonte ecurinë e komisioneve, shtëpive botuese, redaktorëve apo recensuesve.

Realizmi socialist operonte sipas metodës ideologjike dhe artistike, për të bërë të mundur pasqyrimin e realitetit. Zbatimi i parimit bardhë e zi kishte të bënte me zbatimin e parimit të dhënies së mesazheve nga heroi pozitiv.

Duke u mbështetur në parimin Leninist të udhëheqjes ideologjike të letërsisë dhe arteve, sipas mësimëve të marksizëm-leninizmit, Partia krijoi organizatën e shkrimtarëve, më vonë edhe atë të artistëve, me qëllim që krijimtaria letrare dhe artistike në Shqipëri, të ishte nën kontrollin e sistemit të Realizmit Socialist. Në çatinë e këtyre organizatave u bë e mundur që të shtroheshin problemet, të bëheshin diskutime krijuese.

Letërsia dhe artet duhet të kishin në objekt të trajtesave të tyre çështja e socializmit dhe komunizmit. Detyrat revolucionare të Partisë, duhet të realizohen nga shkrimtarët dhe artistët. Realizimi i këtyre detyrave të porositura sipas Partisë-shtet, duheshin kryer nën përgjegjësinë e plotë, ku socializmi dhe mendimi proletar marksist-leninist të ndihen dhe ta përshkruajnë fund e krye çdo libër, çdo pikturë, çdo varg, çdo notë muzikore, çdo kënd e qelizë të veprës artistike. Partia ka besim të thellë se shkrimtarët dhe artistët tanë, si kurdoherë, do ta kryejnë me nder këtë detyrë.

Në pretekst të zhvillimit të pikturës, kërkohej nga artistët që fryma heroike, trimëria, virtytet e larta morale, të ishin si mesazheve për t'u përcjell te publiku. Ku trajtimi i ideologjisë dhe propaganda komuniste, shihej si një sukses i radhës në çdo fushë.

³⁶ Enver Hoxha, Raporte e fjalime, 1972-1973, f. 321.

Bibliografia

- Aliu, Gëzim, *Romanet e Ismail Kadaresë 1963-1990 (retorika e tekstit dhe narracioni)*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2016.
- Borova, Faruk, *Roli i medias si pushtet i katërt në demokraci*, botuar në revistën: “Univers”, nr. 19, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, 2018.
- Dado, Floresha, *Letërsi e painterpretuar*, Bota Shqiptare, Tiranë, 2010.
- Enciklopedia shqiptare, Akademia e Shkencave e RPSSH, Redaksia e Përgjithshme e Enciklopedisë Shqiptare, Tiranë, 1989.
- Engels, Marks, *Mbi kulturën dhe artin*, Shtëpia Botuese “Rilindja”, Prishtinë, 1974.
- Fico, Agron, *Partia në këngën e popullit*, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1979.
- Fjala e shokut Ramiz Alija mbajtur në kongresin e IV të PPSH, botuar në revistën: “Nëntori”, nr. 3, mars, Tiranë, 1961.
- Gjata, Fatmir, *Idetë e Leninit triumfojnë në artin e realizmit socialist*, botuar në revistën: “Nëntori”, nr. 4, prill, Tiranë, 1960.
- Gjergo, Edison, Dosja e hetuesisë/Ministria e Brendshme, nr. 10667/1-A, “Për të pandehurin Edison Gjergo”, Akuza: “Agjitacion dhe Propagandë”, Në bazë të nenit 73/I, Data e fillimit 13 janar 1975, Data e mbarimit 8 prill 1975.
- Hasani, Selim, *Rapsodi popullore*, Tiranë, 1966, f. 48.
- Hoxha, Enver, *Çështje të revolucionit dhe të ndërtimit socialist*, në: “Përmbledhje veprash”, vëll. III.
- Hoxha, Enver, *Gjithmonë vigjilencë - për organet e punëve të brendshme*, vëllimi II.
- Hoxha, Enver, *Letra të zgjedhura*, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1985, f. 389.
- Hoxha, Enver, *Mbi letërsinë dhe artin*, Tiranë, 1977.
- Hoxha, Enver, *Raporte e fjalime*, 1965-1966.
- Hoxha, Enver, *Raporte e fjalime*, 1972-1973.
- Hoxha, Ermir, *Kulti i individit dhe arti totalitar*, në revistën: “Studime për artin”, nr. 14, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Departamenti i Arteve, Tiranë, 2011.
- Intervistë me Gjergj Xhuvanin-regjisor (22.03.2016).
- Intervistë me Mark Pacin-historian-etnograf, gjak i origjinës së At Gjergj Fishtës.
- Intervistë me piktorin Ali Oseku (16.02.2019).
- Jakllari, Adem, *Sundimi i tejskajshëm i shoqërisë, “Patologjia” e akulturacionit si paradigmë zotëruese dhe format e refuzimit të saj në Shqipërinë totalitare*, në: “Pasojat e diktaturës-qëndrimi ndaj shtypjes dhe mësimet”, Botues: Konrad-Adenauer-Stiftung e.V. Zyra e Tiranës Dr. Willibold Frehner.
- Këngë për Partinë, Instituti i Folklorit, Shtypshkronja “Mihal Duri”, Tiranë, 1966.
- Kongresi i 7-të i BRPSH - Elbasan, 26-29 shtator, Botim i KQ të BRPSH, Tiranë, 1977.
- Lenin, V.L. & Stalin, J. V, *Mbi rolin udhëheqës të partisë në ndërtimin socialist*, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1981.
- Marks dhe Engels për kulturën dhe artin, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1960.

- Marku, Mark, *Letërsi e angazhuar dhe autorë të angazhuar*, në: “Studime albanologjike”, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Tiranë, 2009.
- Milosh, Česlav, *Mendje e robëruar*, Botimet Dritero, Tiranë, 1998.
- Për Partinë shqipe mali, Instituti i Folklorit, Shtypshkronja “Mihal Duri”, Tiranë, 1961.
- Raportet vjetore për letrat nga populli në vitet 1980 që ruhen në AQSH, F. 14/AP.
- Sinani, Shaban, *Letrarësia dhe vërtetësia*, botuar në revistën shkencore-kulturore: “Perla”, nr. 4, Tiranë, 2009.